



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Për:
Ymer Fejzullahu
Kryesues i Bordit të ZRRE

Kopje:
Artane Rizvanolli
Ministre – Ministria e
Ekonomisë

Bordi i KEK
Bordi i ZRRE

Data: 20.02.2024

Çështja: Komentet e KEK në Raportet Konsultativ.

I nderuar z. Fejzullahu,

Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a ka shfrytëzuar mundësinë e konsultimit publik në lidhje me Raportet Konsultative për të hyrat e lejuara maksimale për FSHU, OSSH dhe OST, për të parë dhe analizuar vlerësimin e ZRRE-së në lidhje me koston e blerjes së energjisë nga KESCO, KEDS dhe KOSTT e të cilat ndërlidhen me blerjet vendore, përkatësisht blerjet nga KEK-u.

Siç jeni njoftuar, para se palët të dorëzojnë Aplikimet e tyre për shqyrtimin tarifor “Kërkesën për të hyrat e lejuara maksimale për vitin tarifor 2024/25”, KEK ka zhvilluar diskutime për rishikimin e çmimeve të energjisë elektrike, krahasuar me çmimet ekzistuese të cilët përfundojnë me datën 31.03.2024 kur edhe përfundon viti tarifor 2023/24. Në kuadër të këtyre diskutimeve, KEK ka dërguar zyrtarisht njoftimin për përfundimin e marrëveshjes për çmime me datën 31.03.2024 dhe propozimin e çmimit të rishikuar duke filluar nga data 01.04.2024.

Duke marrë në konsideratë faktin se përgjatë periudhës 2021 deri 2023 tarifat e KOSTT për OS dhe OT janë rritur në vazhdimësi, dhe kjo rritje ka prodhuar efekt direkt në koston e prodhimit të energjisë elektrike për KEK-un dhe në anën tjetër rritja e inflacionit e cila ka prodhuar efektin e rritjes së çmimeve për të gjitha produktet dhe shërbimet që ndikojnë në koston e prodhimit të energjisë elektrike, bazuar në analizat e brendshme të KEK-ut, është vlerësuar që rritja e çmimeve të energjisë elektrike për të mbuluar të gjitha kostot e prodhimit është e pashmangshme, prandaj për periudhën e cila fillon nga 01.04.2024 deri 31.03.2025 Korporata Energjetike e Kosovës inkurajon ZRRE-në që në të hyrat e lejuara maksimale për palët KEDS, KESCO dhe KOSTT të përfshijë koston reale për blerje të

20-02-2024

Nr.

PRISHTINË - A

Nga: **Përparim Kabashi**
Zv. Kryeshef Ekzekutiv (ud)
Korporata Energjetike e Kosovës
Sheshi Nënë Tereza nr. 36
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës
www.kek-energy.com

energjisë elektrike nga KEK-u. Çmimet e rishikuara nga KEK për periudhën e cila fillon nga data 01.04.2024 deri 31.03.2025 duhet të reflektohen si vijojnë:


- Çmimi i energjisë Elektrike për mbulimin e Furnizimit për Shërbim Universal - 31.50 €/MWh;
- Çmimi i energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në shpërndarje – 39.10 €/MWh;
- Çmimi i energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në transmetim – 39.10 €/MWh;

Vlen të theksohet, se çmimet e energjisë elektrike të propozuara nga KEK-u për vitin tarifor 2024/25 është pak më i lartë se çmimi aktual me të cilin furnizohet KESCO, mirëpo është dukshëm më i ulët krahasuar me çmimet e tregut në vend dhe rajon. Andaj, për periudhën e ardhshme duke filluar nga 01.04.2024, KEK kërkon nga ZRRE që së paku të reflektojë koston mesatare të prodhimit të energjisë elektrike si dhe mbulimin e kostove shtesë që barten nga rritja e tarifave të KOSTT edhe për kundër faktit që çmimet e tregut të energjisë elektrike janë më të larta. Kur dihet që ZRRE-ja tek operatorët tjerë përmes raporteve konsultative ka pranuar njohjen e kostove shtesë për të mbuluar inflacionin prej 5.41%, andaj më e pakta e cila do duhej që ZRRE të njoh ndryshimin e çmimeve të KEK kundrejt KESCO, KEDS dhe KOSTT reflektimi i inflacionit prej 5.41%.

Vlen të theksohet se çmimet e energjisë elektrike të Korporatës Energjetike të Kosovës nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim minimal që nga viti 2019 edhe përkundër faktit që përgjatë kësaj periudhe për veç faktit që këto çmime nuk kanë mbuluar koston mesatare të prodhimit të energjisë elektrike, gjithashtu KEK është ballafaquar edhe me rritje të kostove tjera direkte.

Korporata Energjetike e Kosovës do të ju ofrojë të gjitha informatat relevante me qëllim që kostoja shtesë e bartur nga operatorët tjerë të reflektohet saktësisht në çmimet e energjisë elektrike me shumicë dhe me qëllim që KEK të mos mbajë këtë barë mbi vete.

Me respekt,



Përparim Kabashi

Zv. Kryeshef Ekzekutiv (ud)

